



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**Anr.745/2021**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferki Xhaferi kryesues, Rrustem Thaqi dhe Faton Ademi anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Podujevës Çlirim Shala nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës, dega në Komunën e Podujevës, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur me datë 06.11.2021, mori këtë:

#### **V E N D I M**

**Hudhet i palejuar apeli** Anr.745/2021, e datës 04.11.2021, parashtruar nga Çlirim Shala nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës, dega në Komunën e Podujevës, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021.

#### **A r s y e t i m**

Me datë 04.11.2021, PZAP-i ka pranuar apelin Anr.745/2021 të parashtruar nga Çlirim Shala nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës, dega në Komunën e Podujevës, me të cilën thekson se sipas dyshimit të tij në zgjedhjet e 17 tetorit votat e qytetareve janë tjetërsuar. Në vendvotime në të cilat kanë votuar familjaret e bashkëfshataret e mi nuk figurojnë votat fare në këto qendra votimi 1812E/01R, 1812E/02R, 1812E/03R, 1812E/04D si dhe ka bashkangjitur deklaratat e personave që kanë votuar në këto qendra.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

#### **Apeli është i palejuar**

Paneli pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se apeli i parashtruar nga Çlirim Shala nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës, dega në Komunën e Podujevës, ka njëjtësi subjektive, objektive, gjendje të njëjtë faktike me apelin e parashtruar po nga Çlirim Shala Kandidat për kuvend Komunal në Komunën e Podujevës të paraqitur me datën 04.11.2021 është vendosur me vendimin e PZAP-it Anr.848/2021 të datës 05.11.2021.

Nga kjo gjendje e vërtetuar faktike rezulton fakti se Apeli i parashtruar nga Çlirim Shala nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës, dega në Komunën e Podujevës, është konsumuar me vendimin A.nr.848/2021 i datës 05.11.2021.

Meqenëse për rastin në fjalë është vendosur me vendimin e PZAP-it, Anr.848/2021 të datës 05.11.2021, dhe pasi që për të njëjtën çështje është vendosur në vendimin e lartcekur paneli nuk u lëshua fare në shqyrtim të kësaj çështje të theksuar në ankesë.

Paneli, duke u bazuar në arsyet e cekuar më lartë e po ashtu në pajtim me dispozitat e nenit 6.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it 02/2015, si dhe në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
Anr.745/2021 më datën 06.11.2021

**Kryesues i Panelit**  
**Ferki Xhaferi**



**Këshillë Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.